



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 259, datë 23.07.2020

PËR
PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR RIKTHIMIN NË DETYRË
TË {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97, 98, 100 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 151 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36/3 të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 66 të Kodit të Procedurës Administrative, në propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga {...}, për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit të Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, bashkë me vendimin përfundimtar.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR